



Përmirësimi i kujdesit për fëmijët

Vlerësimi i arritjeve në promovimin e përmirësimeve sistematike të kujdesit ndaj fëmijëve në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë

Prill 2025



SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
SHQIPËRI



SOS
KINDERDÖRFER
WELTWEIT



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Ky broshurë është botuar me mbështetjen bujare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në kuadër të projektit E drejta për familje – Deinstitutionalizimi për të reformuar sistemet e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë.

Projekti i udhëhequr nga Hermann- Gmeiner -Fonds Deutschland e.V./SOS- Kinderdörfer weltweit zbatohet në pesë vende: Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë, nga organizatat përkatëse anëtare të SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë.

Ky botim është i disponueshëm në versionin elektronik dhe të printuar, dhe në gjashtë gjuhë: shqip, armenisht, rusisht, maqedonisht, ukrainisht dhe anglisht.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e shprehura më poshtë janë ato të autorëve, redaktorëve dhe kontribuesve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e agjencive zbatuese ose të donatorit, dhe asnjë prej tyre nuk mund të vihet para përgjegjësisë për këtë.

Përmbajtja

Rreth projektit	4
Shqipëria	6
Projekti në Shqipëri	6
Arritjet kryesore	7
Praktika jonë më e mirë	9
Armenia	12
Projekti në Armeni	12
Arritjet kryesore	13
Praktika jonë më e mirë	15
Bjellorusia	18
Projekti në Bjellorusi	18
Arritjet kryesore	19
Praktika jonë më e mirë	21
Maqedonia e Veriut	24
Projekti në Maqedoninë e Veriut	24
Arritjet kryesore	25
Praktika jonë më e mirë	26
Ukraina	30
Projekti në Ukrainë	30
Arritjet kryesore	31
Praktika jonë më e mirë	33
Lidhja e njohurive, frymëzimi i ndryshimit	37
Mësimet dhe shkëmbimet në shifra	37

Rreth projektit

Projekti E Drejta për Familje – Deinstitutionalizimi për të Reformuar Sistemet e Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë synon të mbështesë deinstitutionalizimin dhe reformat e sistemit të kujdesit alternativ ndaj fëmijëve në pesë vendet, duke promovuar respektimin e të drejtave dhe dinjitetin e fëmijës dhe duke kontribuar në mundësi të barabarta për rritje dhe zhvillim për të gjithë fëmijët.

Në vendet e projektit, mijëra fëmijë rriten pa përkujdesje familjare. Shumë prej tyre vendosen në institucione rezidenciale dhe, për më tepër, nuk gëzojnë mjedise të dashura, respektuese, të qëndrueshme dhe të sigurta për të mbështetur talentet dhe potencialin e tyre. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve këmbëngulin se është në interesin më të mirë të fëmijës që të reduktohet deinstitutionalizimi, të zhvillohet kujdesi i bazuar në familje dhe shërbimet parandaluese të bazuara në komunitet.

Projekti ishte përpjekja jonë e përbashkët për të kontribuar për këto ideale. Ne kërkuam të arrijmë ndryshime të qëndrueshme sistematike duke punuar me vendimmarrësit, institucionet, profesionistët, familjet, komunitetet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Qëllimet tona kryesore ishin:

- Përafrimi i sistemeve kombëtare të kujdesit për fëmijët me standardet dhe parimet ndërkombëtare, duke i dhënë përparësi zgjidhjeve të bazuara në familje dhe në komunitet ndaj kujdesit institucional.
- Rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet e kujdesit të bazuar në komunitet dhe në familje.
- Trajnimi i profesionistëve për të përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe të shërbimeve të tyre.
- Përmirësim i aksesit të fëmijëve pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë dhe i familjeve të tyre në shërbime cilësore të kujdesit, të bazuar në komunitet dhe në familje.

Ne përdorëm një sërë metodash në punën tonë: avokim dhe lobim, rritje dhe fushatë ndërgjegjësimi, rritje kapacitetesh, duke përfshirë përditësimin e metodologjive të punës së profesionistëve dhe ofrim të drejtpërdrejtë të shërbimeve.

Edhe pse është e vështirë që të përmbliiden tre vjet e gjysmë punë të përkushtuar në pesë vende, arritjet tona kryesore përfshijnë:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor kombëtar për kujdesin ndaj fëmijëve dhe politikave publike, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Fushatat ndërgjegjëse përfshinë 7.3 milionë njerëz.
- Mbi 7,000 politikë dhe vendimmarrës dhe profesionistë përmirësuan njohuritë dhe aftësitë e tyre për një sërë çështjesh të kujdesit për fëmijët, të zgjedhura në mënyrë specifike në përputhje me nevojat e tyre.
- Janë zhvilluar dhe promovuar, të paktën, 18 metodologji dhe mjete të reja pune mes profesionistëve të kujdesit për fëmijët, duke promovuar qasje të personalizuara dhe multidisiplinare.
- Mbi 6,000 fëmijë dhe mbi 5,000 prindër u mbështetën përmes shërbimeve cilësore, të bazuara në komunitet dhe në familje në 18 bashki dhe rajone në të pesë vendet.
- Rritja e bashkëpunimit brenda dhe ndërmjet vendeve për të nxitur përpjekjet e përbashkëta dhe për të ndarë praktikat më të mira në reformat e mirëqenies së fëmijëve.



Ministria Federale Gjermane
për Bashkëpunim Ekonomik
dhe Zhvillim siguroi fondin në
vlerën mbi 5.8 milionë Euro.

Projekti u zbatua në
periudhën midis muaji
tetori të vitit 2021 dhe
muaji prill të vitit 2025.

Shqipëria

Shqipëria është një vend që ndodhet në Evropën Juglindore, i vendosur në bregdetin e Detit Mesdhe. Vendi ka një peizazh të larmishëm, i cili varion nga plazhet me diell deri te malet me dëborë. Progresi ekonomik i viteve të fundit ka çuar në një përmirësim të ndjeshëm të standardeve të jetesës për shumë nga 2.8 milionë banorët e saj. Megjithatë, shumë fëmijë, të rinj dhe familje kanë nevojë për mbështetje shtesë.

SOS Fshatrat e Fëmijëve ka mbështetur fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë, në Shqipëri që nga viti 1995.



**SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
SHQIPËRI**

Projekti në Shqipëri

Duke synuar harmonizimin e sistemit shqiptar të kujdesit për fëmijët me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, projekti u fokusua në promovimin e kujdesit me bazë familjare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe në forcimin e përpjekjeve të bazuara në komunitet për të parandaluar ndarjen e familjes. Kjo qasje e dyfishtë mbështeti drejtpërdrejt reformat e vazhdueshme të vendit për deinstitutionalizimin.

Nisma u mirëprit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila caktoi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri si anëtare të komitetit kombëtar drejtues për deinstitutionalizimin dhe bashkëpunoi ngushtë me organizatën gjatë gjithë zbatimit të projektit.

Krahas pranisë së krijuar në Tiranë dhe Shkodër, SOS Fshatrat e Fëmijëve zgjeruan punën e tyre edhe në bashkitë Vlorë dhe Korçë, të cilat u zgjodhën nga Ministria si njësi pilot për transformimin e institucioneve të kujdesit publik në shërbime me bazë komunitare.

Arritjet kryesore

Përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave publike

- Në vitin 2024 u prezantua zyrtarisht modeli i parë kombëtar i kujdesit për të rinjtë, që vendos standarde për të mbështetur të rinjtë nën kujdes dhe ata që dalin nga kujdesi.
- Promovimi i metodologjisë së llogaritjes së kostos së kujdesit familjar.
- Në katër bashki është zhvilluar modeli i regjistrimit të kujdesit familjar për të përmirësuar gjurmimin, monitorimin dhe planifikimin e vendosjeve dhe shërbimeve. Ky model është miratuar zyrtarisht nga Bashkia Korçë dhe Vlorë, dhe është në proces miratimi në dy bashkitë e tjera.
- Vendimmarrësit në Tiranë dhe Shkodër miratuan zyrtarisht udhëzimet për menaxhimin e rasteve dhe mjetet e standardizuara për të mbështetur fëmijët dhe familjet vulnerabël.

Rritja e ndërgjegjësimit

- Fushata promovuese e kujdesit familjar "Shumë dashuri nën një çati" përfshiu mbi 860.000 njerëz, dhe për këtë u përdorën radio, media sociale, reklama televizive dhe aktivitete publike. Fushata ishte e ngjashme me traditën e Shqipërisë për sa i takon kujdesit farefisnor.
- 1.563 qytetarë morën pjesë në 43 aktivitete të komunitetit për të mësuar rreth mundësive dhe kërkesave për t'u bërë familje kujdestare.
- 423 pjesëmarrës morën informacion të thelluar se si të fillonin procesin e kujdesit familjar.
- 16 familje potenciale u identifikuan si familje të mundshme për t'u bërë kujdestarë familjarë.
- 5 familje të reja kujdestare u regjistruan nga autoritetet deri në fund të vitit 2024, duke ofruar përkujdesje për 5 fëmijë.
- 7 familje po ndërmarrin procedurat ligjore për t'u bërë familje kujdestare.
- 10 gazetarëve iu dha informacion i detajuar për kujdesin familjar, sfidat e përfshira dhe rëndësinë e nënvizimit të kësaj çështjeje jetike në raportimin e tyre.

Rritja e kapaciteteve

- 131 profesionistë të trajnuar për menaxhimin e rasteve dhe ri-integrimin në familje.
- 122 profesionistë të trajnuar në zbatimin e programeve të prindërimit.
- 88 profesionistë dhe 5 të rinj me përvojë lidhur me kujdesin të trajnuar në Metodologjinë e përgatitjes për largimin nga kujdesi, që synon mbështetjen e të rinjve në tranzicion nga kujdesi alternativ.
- 80 palë të interesuara nga 4 bashkitë e synuara kanë përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre për kujdesin familjar.
- 14 vendimmarrës kombëtarë dhe vendorë morën pjesë në një vizitë studimore në Maqedoninë e Veriut, duke fituar njohuri mbi përvojën e vendit në promovimin dhe zbatimin e kujdesit familjar.
- 40 vendimmarrës dhe profesionistë morën pjesë në një takim shkëmbimi për të ndarë praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga deinstitutionalizimi.



Aksesi në shërbime cilësore

- 4 qendra komunitare në Tiranë (2), Vlorë dhe Korçë u shndërruan në mjedise të sigurta dhe stimuluese për mësimin, rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe prindërve.
- 421 fëmijë përfituan mbështetje psikologjike, logopedi, fizioterapi, kampe verore dhe mbështetje arsimore pas shkollës.
- 213 prindër dhe 113 fëmijë u trajnuan për zhvillimin e fëmijëve dhe mësuat teknika të disiplinës efektive dhe jo të dhunshme për të krijuar një mjedis shtëpiak edukues.

Praktika jonë më e mirë

Qendra komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes

Pika e nisjes

Për dekada me radhë, sistemi i kujdesit për fëmijët në Shqipëri bazohej në kujdesin rezidencial. Disa breza fëmijësh pa kujdes prindëror u rritën në institucione rezidenciale të mëdha, 'gri', të ndara, pa dashurinë dhe kujdesin e një familjeje për t'i ndihmuar ata që të zhvilloheshin. Ashtu si kudo, institucione të tilla ofronin mundësi të kufizuara për fëmijët për të zhvilluar talentet dhe potencialet e tyre, duke e dëmtuar përfshirjen e tyre të ardhshme në shoqëri si qytetarë aktivë dhe kontribues.

Shërbimet parandaluese të bazuara në komunitet për familjet në rrezik ndarjeje ishin të kufizuara dhe mbështeteshin kryesisht në iniciativat qytetare dhe financimin e donatorëve. Gjithashtu, mungesa e opsioneve të kujdesit familjar, përveç kujdesit të rastësishëm farefisnor, i linte fëmijët vulnerabël në kushtet e rrezikut të lartë të institucionalizimit. Shumë profesionistë të kujdesit për fëmijët ishin kundër ndryshimeve, pasi kishin akses të kufizuar në qasjet moderne, të bazuara në të drejtat dhe të përqendruara te personi, që fokusoheshin në fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve.



Gjetja e rrugës së duhur

Duke u mbështetur në përvojën e gjatë në shërbimet parandaluese dhe mbrojtëse, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri ka mbështetur zhvillimin dhe funksionimin e qendrave komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes, të projektuara si qendra shërbimi social multidisiplinor. Këto qendra ofrojnë shërbime të integruara parandaluese, promovojnë kujdesin familjar dhe rrisin kapacitetin e kujdestarëve dhe profesionistëve të shërbimeve sociale.

Mbështetja e përshtatur ofrohet si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit: fëmijët përfitojnë këshillim psikosocial, aktivitete zbavitëse dhe programe pas shkollës, ndërsa kujdestarët mund të kenë akses në klasat e prindërve, terapinë familjare, mbështetjen administrative, ndihmën për punësim dhe kujdesin në shtëpi.

Qendrat promovojnë në mënyrë aktive kujdesin familjar përmes fushatave ndërgjegjësuëse, informimit të komunitetit dhe trajnimit të prindërve të ardhshëm kujdestarë, duke i udhëzuar ata në procesin e integritetit brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Me mbi 30 vjet përvojë në kujdesin ndaj fëmijëve në Shqipëri, SOS Fshatrat e Fëmijëve ka mësuar se reforma kuptimplote kërkon bashkëpunim dhe koordinim të fortë me të gjithë aktorët. Këto qendra komunitare novatore përdorin një qasje shumëdisiplinore, të bazuar në menaxhimin e rasteve për të përkthyer nevojat në mbështetje të koordinuar për fëmijët dhe familjet, në partneritet me institucionet publike dhe private.

Në rrugën e ndryshimit

Në Vlorë dhe Korçë u krijuan dy qendra të reja komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes si pjesë e transformimit të institucioneve rezidenciale të kujdesit në këto zona. Dy qendra ekzistuese në Tiranë, që kanë qenë funksionale përpara projektit, vazhduan të shërbejnë si modele. Njësitë vendore siguruan ndërtesa publike - të përdorura më parë për qëllime të tjera - për qendrat e reja.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri bashkëpunoi me autoritetet vendore për të rinovuar dhe përmirësuar ambientet, të cilat tani përfshijnë klasa, dhoma terapie, ambiente lojërash, zyra të stafit dhe hapësira takimi.

Profesionistët u trajnuan për menaxhimin e rasteve, promovimin e kujdesit prindëror, programet e prindërimit të bazuara në dëshmi dhe metodologji të tjera përkatëse. Përveç ofrimit të mbështetjes së drejtpërdrejtë, ata mbrojnë modele të kujdesit të bazuar në familje.

Projekti shpalli fushata ndërgjegjësuëse publike në partneritet me bashkitë, institucionet vendore dhe shoqërinë civile, për të promovuar kujdesin e bazuar në familje. Komunikimi i vazhdueshëm dhe angazhimi i komunitetit kanë qenë çelësi për ndërtimin e besimit publik dhe pranimin e modelit të ri.

Destinacioni: Përmirësimi i standardeve

Megjithëse qendrat komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes filluan të funksionojnë në periudha të ndryshme, ndikimi i tyre në jetën e fëmijëve dhe familjeve ka qenë i rëndësishëm.

Fëmijët dhe familjet tani kanë akses të përmirësuar në një gamë të gjerë shërbimesh të përshatura. Qendrat monitorojnë mirëqenien e tyre, avokojnë për të drejtat e qytetarëve dhe ofrojnë ndihmë administrative për të fuqizuar klientët. Mbështetja pas shkollës përfshin klasa në anglisht, shqip dhe matematikë. Prindërit mund të përmirësojnë aftësitë e tyre prindërore, ndërsa familjet e ardhshme kujdestare marrin ndihmë me procedurat dhe vlerësimet psikologjike për proceset lig-

jore. Ofrohen gjithashtu edhe informacioni, trajnimi dhe mentorimi - të gjitha në një vend.

Qendrat janë proaktive në identifikimin e hershëm të nevojave dhe ofrimin e ndërhyrjeve në kohë. Klientët lidhen me shërbimet e duhura nëpërmjet një protokolli të strukturuar referimi, duke nxitur bashkëpunimin ndërsektorial dhe duke siguruar kujdes holistik.

Çdo ekip shumëdisiplinor zakonisht përfshin një koordinator, punonjës socialë të specializuar në fuqizimin e familjes dhe edukimin e prindërve, psikologë dhe staf mbështetës në shtëpi – duke u shërbyer familjeve me dhe pa anëtarë me aftësi të kufizuara. Një specialist i kujdesit familjar është gjithashtu pjesë e ekipit që siguron mbështetje cilësore për kujdesin me bazë familjare.

Qendrat menaxhohen plotësisht nga bashkitë e tyre përkatëse dhe janë të integruara në strukturat administrative vendore. Secila mbikëqyret nga drejtoria bashkiake e shërbimeve sociale, duke forcuar pronësinë vendore, angazhimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë.

Shërbimet shumëdisiplinare si këto duhet të jenë të aksesueshme në çdo bashki dhe në nivel rajonal, në përputhje me kërkesat ligjore, për të mbështetur familjet dhe për të ofruar kujdes alternativ për fëmijët në rrezik ose pa kujdes prindëror. Këto qendra përfaqësojnë një hap jetik drejt këtij qëllimi.

Këto qendra model demonstrojnë se si praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi fillestar mund të mbështesin përsëritjen në bashkitë e tjera.



Mësimet tona / Për bashkudhëtarët në rrugën e ndryshimit

Partneritetet me autoritetet qendrore dhe vendore kanë dëshmuar, së bashku me angazhimin aktiv të komunitetit, se kanë rëndësi thelbësore për qëndrueshmërinë. Këto bashkëpunime përmirësojnë ofrimin e shërbimeve, sigurojnë ndikim afatgjatë dhe promovojnë pronësinë vendore.

Fushatat ndërgjegjësuere strategjike dhe kulturore të ndjeshme luajnë një rol jetik në ndryshimin e qëndrimeve shoqërore. Ndërkohë që ndryshimi i mentalitetit kërkon kohë, përpjekjet e vazhdueshme ndërgjegjësuere ndihmojnë në krijimin e komuniteteve më gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse.

Dëgjimi dhe përforsimi i zërave të fëmijëve dhe familjeve nuk është vetëm një vlerë thelbësore, por është një domosdoshmëri. Përvojat e tyre të jetuara duhet të udhëheqin çdo ndërhyrje për të siguruar ndryshim domethënës dhe të qëndrueshëm.

Qendrat komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes janë bërë një model udhëheqës në Shqipëri, duke demonstruar sesi shërbimet inovative, shumëdisiplinare dhe të personalizuar mund të plotësojnë në mënyrë efektive nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe familjeve.



”

[SOS Fshatrat e Fëmijëve] sollën jo vetëm ekspertizë, por përkushtim të vërtetë - veçanërisht kur bëhej fjalë për drejtimin e procesit të llogaritjes së kostos së kujdesit alternativ. Kjo lloj pune nuk renditet gjithmonë e para, por është thelbësore dhe ne e vlerësojmë thellësisht.

Unë jam mirënjohëse në mënyrë të veçantë për mbështetjen në realizimin e tre rasteve të kujdesit familjar këtu në Vlorë. Këto mund të duken si shifra të vogla, por pas secilës prej tyre është një fëmijë, jeta e të cilit ka ndryshuar për mirë - dhe kjo është ajo që ka vërtet rëndësi. Kjo tregon se çfarë është e mundur të bëhet kur punojmë së bashku me një vizion të përbashkët për fëmijët që rriten në mjedise familjare të sigurta dhe të dashura.

Gjithashtu, këto vitet e fundit kanë qenë edhe një kohë transformimi për ne. Jam krenare në mënyrë të veçantë për mënyrën se si e kemi rimenduar dhe ripërdorur institucionin e vjetër të kujdesit rezidencial. Sot, nuk është më një vend ndarjeje, por një qendër e ngrohtë dhe mikpritëse komunitare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes—një vend plot jetë, aktivitet dhe shpresë për familjet në nevojë.”

Znj. Irena Stasa, Drejtoreshë e Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Vlorës

Armenia

Armenia është një vend malor, pa dalje në det në Kaukaz, me një popullsi prej rreth 2.9 milionë banorësh. Kryeqyteti Jerevan ka një popullsi prej rreth një milion banorësh. Rreth 35-40% e armenëve jetojnë në zonat rurale. Armenia përballlet me sfida me papunësi të lartë dhe aftësi pune që nuk përputhen me vendet e punës në dispozicion. Qeveria ka trajtuar disa nga pabarazitë e të ardhurave që janë hasur në dekadat e mëparshme. Megjithatë, kohët e fundit vendi ka parë rritje të shkallës së varfërisë dhe një vulnerabilitet në rritje të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Armeni ka mbështetur që nga viti 1.988 fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë.

Projekti në Armeni

Në mbështetje të deinstitutionalizimit, projekti synonte të zvogëlonte numrin e fëmijëve në kujdesin institucional dhe të rriste aksesin në shërbimet e parandalimit, kujdesin në komunitet dhe mbështetjen -përfshirë ri-integrimin në familje - për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë. Masat kryesore për arritjen e këtyre objektivave përfshinin përafrimin e legjislacionit kombëtar me Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e kujdesit familjar dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve.

Shërbimet e forcimit të familjes u përqendruan kryesisht në qytetin e Jerevanit dhe rajonin e Shirakut, ndërkohë që disa aktivitete të projektit u zbatuan në nivel kombëtar në të gjitha rajonet e Armenisë.

Arritjet kryesore

Deri në fund të vitit 2023, qeveria raportoi¹ një rënie prej 25% të numrit të fëmijëve të institution-alizuar, me një numër në rritje të fëmijëve që riintegrohen në familjet e tyre ose vendosen në kujdesin e bazuar në familje.

U zgjeruan gjithashtu edhe masat parandaluese dhe shërbimet e kujdesit të bazuar në komu-nitet, pavarësisht krizës humanitare të vitit 2023, e cila solli mbi 100.000 persona të zhvendosur - duke përfshirë 30.000 fëmijë - nga Nagorno-Karabakh në Armeni.

Përmirësimi i legjislacionit dhe politikave publike

- Janë hartuar dhe dorëzuar për miratim rekomandimet për kujdestarinë, kujdesin fafesis-nor, adoptimin, standardet dhe monitorimin e shërbimit social dhe prokurimin e shërbimeve. Të gjitha propozimet janë harmonizuar me standardet kryesore ndërkombëtare dhe prakti-kat më të mira.
- Janë organizuar më shumë se 20 tryeza të rrumbullakëta, seminare dhe takime për të përmirësuar aftësitë e profesionistëve në njohjen e abuzimit, dhunës dhe neglizhencës



¹ https://www.ombuds.am/images/files/2c1f6e50692f92df376290b6a4ec5121.pdf?utm_source=chatgpt.com fq.68

ndaj fëmijëve, zhvillimin e opsioneve të ndërhyrjes dhe kuptimin e ndikimit në mirëqenien e fëmijëve.

Janë organizuar më shumë se 20 tryeza, seminare dhe takime për të siguruar pjesëmarrjen e palëve të interesuara në zhvillimin e këtyre propozimeve dhe për të promovuar pranimin e tyre.

- Janë organizuar vizita studimore në Austri dhe Shqipëri për përfaqësues nga tetë institucione dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Armenia, me fokus mbrojtjen e fëmijëve, kujdesin alternativ dhe mbështetjen e familjes.
- Mbi 20 përfaqësues të qeverisë morën pjesë në një seminar për përvojën e deinstitutionalizimit të Maqedonisë së Veriut, duke identifikuar mësimet kryesore për të informuar hapat e ardhshëm të Armenisë.

Rritja e ndërgjegjësimit

U organizuar një fushatë kombëtare ndërgjegjësimi në bashkëpunim me vendimmarrësit shtetërorë, universitetin shtetëror të Jerevanit, rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve të Armenisë dhe organizata të tjera për të promovuar kujdesin familjar dhe deinstitutionalizimin.

- Fushata përfshiu afro 370.000 qytetarë armenë, mbi 12.5% të popullsisë së përgjithshme.
- U shpërndanë më shumë se 80 artikuj dhe video përmes kanaleve televizive, gazetave, faqeve zyrtare të internetit të partnerëve dhe platformave të mediave sociale.
- 652 persona gjithsej morën pjesë në veprimtari të ndryshme të fushatës.

Rritja e kapaciteteve

Projekti ofroi trajnime për vendimmarrësit, profesionistët e kujdesit ndaj fëmijëve dhe specialistë të tjerë përkatës në të gjithë vendin. Temat e trajnimit dhe shifrat e pjesëmarrjes përfshinin:

- Referues: 590 të trajnuar.
- Menaxhimi i rastit: 250 të trajnuar.
- Parandalimi, identifikimi dhe reagimi ndaj abuzimit, neglizhencës dhe dhunës së fëmijëve: 220 të trajnuar.
- Kujdesi i Informuar për Traumën: 31 të trajnuar, duke përfshirë 6 trajnerë dhe 2 bashkë-trajnerë.
- Kujdesi familjar: 27 të trajnuar.
- Të drejtat e fëmijëve dhe përfitimet e deinstitutionalizimit: 32 gazetarë të trajnuar.

Për më tepër, 76 prindër dhe 102 fëmijë nga familje në rrezik përfunduan një kurs 14-javor për forcimin e familjes.

Projekti gjithashtu zhvilloi, shpërndau dhe publikoi në internet një udhëzues për raportimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve tek agjencitë e autorizuar.

Aksesi në shërbime cilësore

- 682 fëmijë dhe 597 prindër përfituan shërbime parandaluese.
- 131 fëmijë morën shërbime riintegrimi, 109 prej të cilëve u ribashkuan me sukses me familjet e tyre biologjike.
- 597 kujdestarë morën mbështetje psikosociale (individuale ose në grup).

Praktika jonë më e mirë

Qasje shumëplanëshe për ndryshimet sistematike të mirëqenies së fëmijëve

Pika e nisjes

Për vite me radhë, Qeveria e Armenisë ka demonstruar një angazhim të fortë ndaj reformës së deinstitutionalizimit duke promovuar kujdesin me bazë familjare, duke zgjeruar shërbimet e kujdesit ditor dhe duke forcuar sistemin e kujdesit familjar. Megjithatë, standardet e pamjaftueshme të kujdesit alternativ kanë çuar në mbështetjen e vazhdueshme në kujdesin institucional, duke prishur lidhjet familjare dhe duke dështuar në ofrimin e mbështetjes së mjaftueshme për fëmijët në nevojë.

Në rrugën e ndryshimit

Përmirësimi i standardeve të kujdesit ndaj fëmijëve nëpërmjet reformave legjislative dhe rritjes së kapaciteteve u cilësua si element thelbësor për promovimin e kujdesit të bazuar në familje dhe arritjen e rezultateve më të mira për fëmijët. SOS Fshatrat e Fëmijëve Armenia u përball me sfidën e nxitjes së ndryshimeve sistematike të mirëqenies së fëmijëve duke adoptuar një qasje shumëplanëshe që përfshinte zhvillimin legjislativ dhe zhvillimin e politikave, rritjen e kapaciteteve dhe ndërhyrjen e drejtpërdrejtë.

Këto përpjekje u ndërlikuan më tej nga kriza humanitare në vitin 2023, e cila nënvizoi nevojën urgjente për zgjidhje efikase të kujdesit familjar. Pavarësisht sfidave, partneriteti ynë me Qeverinë e Armenisë mbeti i fortë, me një fokus të përbashkët në zgjerimin e alternativave të bazuara në familje për fëmijët në nevojë. Kriza nuk u pa si një pengesë, por si një katalizator shtesë për ndryshime domethënëse dhe të qëndrueshme.



Destinacioni: Përmirësimi i standardeve

Fillimisht kemi prezantuar programe trajnimi gjithëpërfshirëse për punonjësit socialë dhe ku-



jdestarët, me fokus të përqendruar në bashkimin dhe mbështetjen e familjes. Vënia në zbatim e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale bëri të mundur që të arrijmë të trajnojmë mbi 980 profesionistë shtetërorë, duke rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore mbështetëse për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre. Programet e trajnimit mbuluan legjislacionin kombëtar, standardet e shërbimit social, menaxhimin e rasteve, kujdesin alternativ dhe referimet.

Në kuadër të këtij projekti, SOS Fshatrat e Fëmijëve Armenia investoi në zhvillimin dhe ruajtjen e një partneriteti të fortë dhe efikas me Ministrinë, duke siguruar pjesëmarrjen dhe pronësinë e saj aktive në përpjekjet për të përmirësuar legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve. U formua një grup pune prej dhjetë anëtarësh, i cili përfshinte Zëvendës Ministrin e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe drejtuesit kryesorë të departamenteve. Ky grup kishte për detyrë të hartonte rekomandime legjislative dhe të politikave.

Në fillim të projektit, grupi i punës mori pjesë në një vizitë studimore në Austri, duke fituar njohuri të vlefshme mbi kuadrin ligjor austriak dhe praktikat që lidhen me kujdesin alternativ dhe shërbimet cilësore të mbështetjes së familjes.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve bashkëpunuese, ne realizuam ndryshime të kodit të familjes dhe akte të tjera ligjore përkatëse për t'i përafëruar me Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ për Fëmijët. Këto rekomandime u bazuan në studimin dhe analizën gjithëpërfshirëse të politikave ekzistuese të kujdesit për fëmijët, të kornizave ligjore dhe nevojave specifike të fëmijëve, të familjeve

dhe kujdestarëve. Veçanërisht, janë përmirësuar ndjeshëm rregulloret e komiteteve të kujdestarisë dhe të mbrojtjes së fëmijëve (GTC).

Fushat shtesë të përmirësimit - të trajtuara përmes ndryshimeve në legjislacionin parësor dhe dytësor -përfshinin: vendimet për vendosjen jashtë shtepisë, kujdestarinë mbështetëse, kujdesin dhe birësimin farefisnor, standardet e ofrimit të shërbimeve, sistemet e monitorimit dhe prokurimet

publike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Në vitet e fundit, kujdesi institucional ka rialokuar burime publike për shërbimet e bazuara në familje dhe komunitet, duke mbështetur përpjekjet për riintegrim dhe zhvillimin e modeleve të kujdesit me bazë familjare.

Njëkohësisht, projekti ofroi shërbime parandaluese dhe riintegruese në komunitetet vendore, duke nxjerrë njohuri praktike ku u bazuan reformat ligjore të propozuara.

Këto përpjekje kontribuan së bashku në një rënie të raportuar prej 25% të numrit të fëmijëve të institucionalizuar në Armeni. Ky përmirësim i mirëqenies së fëmijëve dhe i stabilitetit të familjes u mbështet nga rritja e kapaciteteve profesionale midis kujdestarëve dhe profesionistëve të vijës së parë, të cilët luajtën një rol kritik në zbatimin efikas të legjislacionit të ri dhe masave të politikave.

Mësimet tona / Për bashkëudhëtarët në rrugën e ndryshimit

Aplikimi i një qasje shumëplanëshe për të promovuar ndryshimet sistematike. Në përvorjen tonë, kombinimi i avokimit për zhvillimin legjislativ dhe të politikave me rritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e shërbimeve (d.m.th., ndërhyrja e drejtpërdrejtë) rezultoi shumë e efektshme.

Angazhimi i hershëm dhe në mënyrë të vazhdueshme i palëve kryesore të interesit të qeverisë për të krijuar mirëkuptim dhe besim të ndërsjellë. Ndërkohë që e zyrtarizua këtë bashkëpunim përmes një Memorandumi Mirëkuptimi, ne mbajtëm edhe një komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm gjatë gjithë projektit.

Identifikimi, në kuadër të përpjekjeve të avokimit, i qëllimeve të përbashkëta me zyrtarët e qeverisë dhe përkushtimi për t'i arritur ato. Bashkë-hartimi i legjislacionit dhe i masave të politikave, duke

u mundësuar përfaqësuesve të qeverisë që të marrin drejtimin e sigurimit të praktikitetit dhe të zbatueshmërisë së zgjidhjeve të propozuara.

Përdorimi i rritjes së kapaciteteve për të forcuar marrëdhëniet midis profesionistëve shtetërorë dhe joshtetërorë të kujdesit për fëmijët. Përfshirja e të dy grupeve në sesione të përbashkëta trajnimi për të nxitur besimin dhe bashkëpunimin. Lehtësimi i shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizës - kjo është një formë efikase për rritjen e kapaciteteve dhe avancimin e qëllimeve të përbashkëta.

”

Kontributi i grupit të punës ka qenë shumë efikas dhe i vlerësuar në avancimin e reformave.

Tatevik Stepanyan , Zëvendës Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale.

”

Ne kurrë nuk do t'i lejojmë fëmijët tanë të ndihen më të braktisur. Ne e dimë se mund t'i kapërcejmë të gjitha vështirësitë së bashku.

thanë dy prindër që janë klientë të shërbimeve të riintegrit

”

Ky program na ka ofruar njohuri dhe aftësi praktike të paçmueshme që mund t'i zbatojmë menjëherë në punën tonë të përditshme. Është një hap i rëndësishëm përpara për mbrojtjen e fëmijëve në vendin tonë.

Arman Grigoryan , pjesëmarrës dhe Drejtor i një institucioni lokal të kujdesit.

”

Bashkëpunimi afatgjatë midis SOS Fshatrave të Fëmijëve Armenia dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale ka rëndësi thelbësore për avancimin e rritjes së kapaciteteve.

Vanand Karapetyan , Drejtues i Institutit Kombëtar të Punës dhe Kërkimeve Sociale

Bjellorusia

E vendosur në Evropën verilindore, Bjellorusia ka një popullsi prej afro 9.5 milionë banorësh. Më pak se 20% e popullsisë janë nën moshën 18 vjeç, duke e bërë atë një vend me një nga nivelet më të ulëta të lindjeve në botë. Shumë prej këtyre fëmijëve dhe të rinjve kanë nevojë për mbështetje në mënyrë që të rriten të sigurt dhe të kenë një të ardhme që meritojnë.


SOS Fshatrat e Fëmijëve ka mbështetur fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë, në Bjellorusi që nga viti 1995.



Projekti në Bjellorusi

Duke synuar uljen e numrit të fëmijëve të vendosur në institucionet afatgjata rezidenciale, projekti synoi të përmirësojë aksesin në shërbimet parandaluese dhe të bazuara në komunitet për fëmijët në nevojë, të forcojë kapacitetin e profesionistëve për të aplikuar metodologji të provuara, të përditësuara dhe të rrisë mbështetjen publike për përpjekjet lidhur me deinstitutionalizimin.

Zbatimi u përqendrua në rajonet Minsk dhe Mogilev, ndonëse shumë aktivitete u realizuan në nivel kombëtar.



Arritjet kryesore

Numri i fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale u ul me pothuajse 6% nga fillimi i projektit në fund të vitit 2021 deri në fillim të vitit 2024. Në institucione u vendosën 1.672 fëmijë (12,2%) nga 13.756 fëmijë gjithsej pa kujdes prindëror në vend - krahasuar me 2.750 që u vendosën në vitin 2022.

Përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave publike

- Ministria e Arsimit pranoi propozimet për forcimin e sistemit të kujdesit për fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor dhe ato u përfshinë në Planin Kombëtar të Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Fëmijëve dhe Mbrojtjen e të Drejtave të tyre për periudhën 2022 - 2026.
- Mekanizmi kombëtar për ndihmën ndaj viktimave të mitura të dhunës dhe shfrytëzimit seksual është zhvilluar në vitin 2023, me pjesëmarrjen e SOS Fshatrave të Fëmijëve. Propozimet për përmirësim u dorëzuan në vitin 2024.

- Rekomandimet metodologjike për autoritetet e mirëqenies së fëmijëve lidhur me krijimin dhe monitorimin e familjeve kujdestare, të nxjerra nga Ministria e Arsimit në vitin 2024, pasqyrojnë disa nga mësimet kryesore të nxjerra gjatë zbatimit të projektit.
- Propozimet iu dorëzuan autoriteteve në fund të vitit 2024 në lidhje me vënien në funksionim publik të shërbimeve specifike sociale, si rehabilitimi intensiv rezidencial për familjet biologjike dhe kujdestare në krizë, strehimoret për gratë në situata krize, jetesa e pavarur e mbikëqyrur për personat që dalin nga kujdesi e të tjera.

Rritja e ndërgjegjësimit

U përfshinë rreth 20% e popullsisë - afro 2 milionë njerëz - me anë të dy fushatave ndërgjegjëse: njëra për nevojën e deinstitutionalizimit dhe promovimin e prindërve birësues (2022-2024) dhe një tjetër për parandalimin e stereotipeve sociale ndaj fëmijëve vulnerabël (2023-2024).

Rritja e kapaciteteve

U paraqitën shtatë instrumente dhe metodologji të reja ose të përmirësuara për profesionistët e kujdesit për fëmijët:

- Udhëzues i përditësuar i menaxhimit të rasteve.
- Përvoja praktike dhe rekomandime për përmirësimin e kujdesit të ngjashëm me familjen.
- Algoritmi i zhvilluar për forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe rekomandime për aktorët kryesorë rajonalë të përfshirë në punën e parandalimit në familje.
- Mjet monitorimi për vlerësimin e cilësisë së kujdesit dhe kompetencave profesionale dhe prindërore të prindërve kujdestarë.
- Lista kontrolluese e vlerësimit të zbatimit të standardeve të cilësisë së shërbimit.
- Mjete për vlerësimin e nevojave të grupeve të synuara (profesionistë në terren, familje biologjike dhe kujdestare).
- Udhëzues për Dokumentacionin Personal për menaxhimin e dosjeve të fëmijëve në kujdes alternativ.

U zhvilluan shtatë programe të reja trajnimi për profesionistët, prindërit kujdestarë dhe fëmijët dhe familjet vulnerabël:

- Kurs trajnimi për prindër kujdestarë të fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Kurs trajnimi për prindërit birësues lidhur me psikologjinë e zhvillimit dhe vlerësimet e kujdesit lidhur me moshën.

- Mbështetje rehabilitimi social për familjet biologjike dhe familjet kujdestare në krizë.
- Mbështetje riintegruese për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre të origjinës.
- Qasje alternative të kujdesit për foshnjat (fëmijët e moshës 0-3 vjeç).
- Kujdes alternativ për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Aplikacioni celular Unë jam një prind për prindërit.

521 vendimmarrës, profesionistë dhe aktorë të tjerë morën pjesë në ngjarjet e zhvillimit profesional dhe shkëmbimit të përvojave.

3.544 profesionistë morën pjesë në menaxhimin e rasteve dhe/ose programet e prindërimit të bazuar në të dhëna.

Aksesi në shërbime cilësore

- 774 fëmijë pa kujdes prindëror morën kujdes alternativ cilësor, duke përfshirë 44 foshnja dhe 91 fëmijë me aftësi të kufizuara.
- 1.048 fëmijë në rrezik për të humbur kujdesin prindëror morën mbështetje psikosociale.
- 2.185 prindër dhe prindër kujdestarë përmirësuan aftësitë e tyre të prindërimit përmes kurseve edukative, grupeve të vetëdihmës, klubeve të shkëmbimit të përvojave, forumeve dhe aktiviteteve të ngjashme.



Praktika jonë më e mirë

Zhvillim profesional gjithëpërfshirës për profesionistët e kujdesit ndaj fëmijëve Pika e nisjes

Profesionistët e mirëqenies së fëmijëve - që punojnë në arsim, mbrojtje sociale, kujdes shëndetësor dhe zbatim të ligjit - luajnë një rol jetësor në mbrojtjen e fëmijëve në rrezik ose pa kujdes prindëror. Megjithatë, në Bjellorusi, sfidat e vazhdueshme socio-ekonomike e kanë lënë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve të pafinancuar, me personel të pamjaftueshëm dhe me mungesë të infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme. Reformat ligjore, koordinimi i dobët ndërinstitucional dhe mundësitë e kufizuara të trajnimit pengojnë më tej aftësinë e profesionistëve për të ofruar mbështetje efikase ose për të zbatuar reforma kryesore si deinstitutionalizimi.

Profesionistët shpesh nuk janë në gjendje të marrin vendime specifike për rastin pasi janë të rënduar nga dokumentet e tepërta, ngarkesat e mëdha të çështjeve dhe procedurat e ngurta. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj traumës - i kombinuar me mbështetje të pamjaftueshme emocionale - çon në nivele të larta stresi, rraskapitje dhe kënaqësi të pakët në punë, të cilat ndikojnë negativisht në stabilitetin dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen fëmijëve vulnerabël.

Gjetja e rrugës së duhur

Për të trajtuar këto sfida, SOS Fshatrat e Fëmijëve Bjellorusi zhvilluan, në kuadër të projektit të deinstitutionalizimit, një sistem mbështetës gjithëpërfshirës për profesionistët bazuar në tre shtylla: Mëso – Ndaj – Trego kujdes. Ky sistem përfshin trajnime fleksibël, praktik, mjete të përshtatshme për përdoruesit dhe mbështetje të qëndrueshme psikosociale përmes rrjeteve të forta profesionale.

Qasja e përzgjedhur bazohet në parimet që kanë në qendër njeriun, si interesi më i mirë i fëmijës, respekti i ndërsjellë, diversiteti, komunikimi jo i dhunshëm dhe krijimi i hapësirave të sigurt të të mësuarit. Ajo gjithashtu promovon kujdesin për veten, mbështetjen e bashkëmoshatarëve dhe sfidon në mënyrë aktive stereotipet e dëmshme për fëmijët e pambrojtur.

Në rrugën e ndryshimit

Rrethi i rritjes së kapaciteteve dhe transformues, i krijuar për të nxitur në mënyrë gjithëpërfshirëse zhvillimin e profesionistëve të kujdesit për fëmijët, përfshinte disa elementë të ndërlidhur:

- Zhvillimi dhe shpërndarja e kurrikulave gjithëpërfshirëse të trajnimit:

Vlerësimet e plota të nevojave ndihmuan në identifikimin e temave më urgjente, në bazë të të cilave ne zhvilluam kurrikulat dhe materialet për një sërë kursesh trajnimi bazë dhe të avancuara. Temat përfshinin traumën, dhunën në familje, çrregullimet e sjelljes, shëndetin mendor, konfliktin në familje dhe aftësitë e buta, si dhe programin "Prindër të Fortë – Fëmijë të Fortë", Kujdesin e Informuar për Traumën dhe kurse të ndryshme rikualifikimi profesional të certifikuar nga shteti. Metodatat e sugjeruara të ofrimit të trajnimit ishin të larmishme dhe përfshinin formate me një ose me disa sesione, seminare, klasa model dhe konsultime.

- Mësimi nga kolegët dhe rrjetet mbështetëse:

Ne nisëm dhe moderuam komunitetet e praktikës, tryezat e rrumbullakëta, platformat e dialogut dhe veprimtaritë publike për shkëmbimin e përvojave. Vizitat studimore rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare (virtuale) pasuruan më tej përpjekjet tona të shkëmbimit, krahas grupeve dhe komuniteteve tematike të bazuara në rrjetet sociale. Profesionistët e rinj u mbështetën përmes pro-

grameve të strukturuar të mentorimit.

- Zgjidhjet dhe dixhitalizimi i drejtuar nga teknologjia:

Duke përdorur teknologjinë moderne, ne siguroam mbikëqyrje dhe këshillim në distancë - veçanërisht për profesionistët në zona të largëta - duke garantuar që askush të mos mbetet pas. Ne shpallëm një platformë e-learning mbi Kujdesin e Informuar për Traumën dhe praktikat specifike të traumës për psikologët, si dhe një bibliotekë burimesh në internet. Nëpërmjet aplikacioneve të reja celulare, profesionistët fituan akses të shpejtë dhe të lehtë në materialet mbi teknikat e ndërhyrjes në krizë.

- Mbështetja emocionale dhe psikologjike:

Për të ndihmuar profesionistët të menaxhojnë stresin e përditshëm të lidhur me punën, ne shkëmbyem praktikat e vetëdijesimit, strategjitë e kujdesit për veten dhe teknikat e njohjes dhe të sjelljes. Grupet Balint të udhëhequra nga kolegët trajtuan rraskapitjen, stresin traumatik dytësor dhe ekuilibrin punë-jetë. Atyre që kishin nevojë për mbështetje në përpunimin e rasteve dhe të emocioneve të vështira iu ofruan këshillim dhe terapi konfidenciale individuale dhe në grup.

- Mbështetja metodologjike:

Ne përshtatëm dhe lokalizuar metodologjitë ndërkombëtare të bazuara në të dhëna dhe standartet e shërbimit dhe zhvilluam mjete të qarta monitorimi dhe vlerësimi. Ne promovuam, në bashkëpunim me shoqatat profesionale, përdorimin e qasjes së menaxhimit të rasteve për familjet në krizë dhe për familjet kujdestare.

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe angazhimi i komunitetit dhe familjes:

Ne organizuam sistematikisht takime për të nxitur një të kuptuar të përbashkët të çështjeve dhe për të inkurajuar ofrimin e shërbimeve të integruara. Profesionistët u trajnuan për të bashkëpunuar në mënyrë efikase me familjet, drejtuesit e komunitetit, organizatat dhe kompanitë vendore. Ne inkurajuar gjithashtu partneritetet midis intelektualëve, ligjvënësve dhe profesionistëve për të zhvilluar dhe përmirësuar si praktikat ashtu edhe politikat.

Për të shkuar larg, ne ecëm me të tjerët

Një ndërmarrje e tillë komplekse përbënte një përpjekje bashkëpunuese që përfshinte shumë aktorë. Agjencitë qeveritare, si Ministria e Arsimit dhe departamentet bashkiake, mbështetën zhvillimin dhe koordinimin e politikave. Institucionet arsimore dhe organizatat qytetare kontribuan në bashkë-krijimin dhe ofrimin e trajnimeve, ndërkohë që partnerët e sektorit privat ofruan mbështetje dhe burime vullnetare.

Ne përdorëm memorandume mirëkuptimi dhe plane të qarta veprimi për të përcaktuar qëllimet e përbashkëta dhe për të qartësuar rolet. Komunikimi i rregullt, përditësimet e progresit dhe qasja fleksibël ndihmuan në ruajtjen e besimit dhe sigurimin e ndikimit të qëndrueshëm.

Destinacioni: Përmirësimi i standardeve

Ne mblodhëm komente mbi ndikimin e njohurive dhe aftësive të tyre të reja të fituara në punën e tyre të përditshme nga 3.544 profesionistëve të angazhuar përmes aktiviteteve tona të rritjes së kapaciteteve. Ndërhyrjet çuan në: përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve dhe krijimin e mjediseve

më të sigurta, më edukative; familje më të forta me akses më të mirë në mjetet mbështetëse dhe prindërore; profesionistë me kompetenca dhe me aftësi të rritura, motivim të rritur dhe lodhje të reduktuar; dhe përmirësim të bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë.

”

Dikur mendoja se të ndihmoja ishte thjesht ndjekja e protokolleve. Por SOS Fshatrat e Fëmijëve më mësuën se mbështetje e vërtetë do të thotë të mësosh përsëri çdo ditë. Reflektimet e udhëhequra nga kolegët na ndihmojnë që ne zbulojmë rastet e vështira pa gjykuar. Hapësira dialogu, trajnime praktike dhe klasa model që të ndryshojnë këndvështrimin. Kolegët që bëhen më shumë se sa mentorë - një ekip i vërtetë mbështetës dhe një komunitet i lidhur ngushtë. Tani jam e sigurtë: edhe historitë më të vështira përmbajnë shpresë.

Olga, pedagoge sociale, Minsk

”

Ecja në mënyrë profesionale përkrah SOS Fshatrave të Fëmijëve transformoi të gjithë qasjen time për të ndihmuar fëmijët dhe familjet. Këtu unë mësova të shkoj përtej zgjidhjeve të teksteve shkollore - të dëgjoj me të vërtetë, të analizoj dhe të gjej rrugë përpara, edhe në rastet më komplekse. Seancat e mbikëqyrjes, trajnimet dhe shkëmbimet me kolegët u bënë për mua “butoni i rifillimit” të vazhdueshëm profesional. Tani e di me siguri: edhe në krizë, ka gjithmonë vend për ndryshim.

Alena, psikologe arsimit, Mogilev

Mësimet tona / Për bashkëudhëtarët në rrugën e ndryshimit

Mbështetja e profesionistëve të vijës së parë është çelësi i ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve. Ndryshimi i qëndrueshëm kërkon investime të vazhdueshme, praktika të bazuara në të dhëna dhe bashkëpunim ndërsektorial. Për ata që ndjekin qëllime të ngjashme, mësimi është i qartë: filloni me njerëzit, qëndroni fleksibël dhe ndërtoni së bashku.

Mjetet, programet e trajnimit dhe materialet e zhvilluara në kuadër të këtij projekti mund të përshtaten dhe të shkallëzohen në kontekste të tjera për të ndihmuar që më shumë profesionistë të mbështesin fëmijët dhe familjet në mënyrë të efektshme.

Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut është një vend pa dalje në det në Evropën Juglindore dhe ka një popullsi prej 1.8 milionë banorësh. Vendi ka një popullsi të larmishme etnike, duke përfshirë 58% maqedonas, 24% shqiptarë, 4% turq dhe 3% romë. Fëmijët përbëjnë 19 për qind të popullsisë, që janë rreth 400.000 individë. Për shkak të një shkalle relativisht të lartë të papunësisë - mbi 12% - shumë njerëz janë larguar nga vendi dhe janë shpërngulur jashtë vendit për punë.

SOS Fshatrat e Fëmijëve ka mbështetur fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë, në Maqedoninë e Veriut që nga viti 2002.



Projekti në Maqedoninë e Veriut



Si pjesë e strategjisë kombëtare për deinstitutionalizimin, Maqedonia e Veriut shfuqizoi në vitin 2019 institucionet rezidenciale për fëmijë dhe futi licencimin dhe kontraktimin social.

Projekti i SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut u hartua dhe u shpall për të mbështetur zbatimin e vazhdueshëm të kësaj strategjie dhe për të plotësuar zhvillimin, promovimin dhe mbështetjen e shërbimeve të bazuara në komunitet, siç është kujdesi familjar dhe kujdesi për fëmijët me nevoja komplekse.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Instituti Kombëtar për Aktivitetet Sociale, agjencia përgjegjëse për zhvillimin e vazhdueshëm të profesionistëve të mbrojtjes sociale dhe kujdestarëve, ishin partnerët kryesorë dhe emëruan përfaqësues në komitetin drejtues të projektit, së bashku me anëtarë nga organizatat përkatëse qytetare.

Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve u realizuan në nivel kombëtar, me fokus të veçantë në rajonin e Shkupit dhe Pellagonisë.

Arritjet kryesore

Përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave publike

- Projekt ndryshimet e akteve nënligjore iu dorëzuan autoriteteve për miratim, duke siguruar futjen sistematike të Kujdesit të Informuar për Traumën në të gjithë sistemin e mbrojtjes sociale.
- Programi i trajnimit për Kujdesin e Informuar për Traumën është akredituar nga Instituti Kombëtar për Aktivitetet Sociale.

- Qasja e Kujdesit të Informuar për Traumën është përfshirë në kurrikulën zyrtare të Institutit për Punë dhe Politika Sociale në Universitetin shtetëror në Shkup.

Rritja e ndërgjegjësimit

- Rreth 1.38 milionë njerëz u përfshinë përmes fushatës kombëtare të promovimit të kujdesit familjar. Në terma relativë, më shumë se tre të katërtat e popullsisë u informuan nëpërmjet TV-së, radios, internetit dhe mediave sociale.
- Rreth 2.700 njerëz morën pjesë në 45 veprimtari publike të organizuara në të gjitha qytetet kryesore anembanë vendit për të mësuar më shumë rreth kujdesit familjar; 434 individë shprehën interes për t'u bërë prindër kujdestarë.
- 35 familje kujdestare të sapo trajnuara dhe të certifikuara tani kujdesen për mbi 40 fëmijë.



Rritja e kapaciteteve

- 111 profesionistë të mbrojtjes sociale nga i gjithë vendi janë trajnuar për intervista motivuese.
- 69 profesionistë dhe 56 prindër kujdestarë morën trajnime për Kujdesin e Informuar për Traumën si dhe u përgatitën 16 trajnues të Kujdesit të Informuar për Traumën.
- 16 profesionistë nga SOS Fshati i Fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, nga Klinika Shtetërore e Psikiatrisë në Shkup dhe nga Spitali Klinik i Manastirit janë trajnuar për psikoterapi zhvillimore dyadike.
- 13 profesionistë u trajnuan për të ofruar trajnime të specializuara për prindërit kujdestarë që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- 32 prindër kujdestarë u trajnuan dhe u licencuan si kujdestarë të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Akses në shërbime cilësore

- U krijua shërbimi inovativ i këshillimit për fëmijët dhe familjet në rrezik. Përgatitjet përfshijnë rinovimin dhe pajisjen e ambienteve. Për fëmijët është vënë në dispozicion një dhomë shqisore.
- 49 klientë gjithsej janë mbështetur përmes 774 seancave me edukator dhe rehabilitues special dhe 619 seanca me psikolog.

Praktika jonë më e mirë

Ndërtimi i një sistemi efikas për trajtimin e traumave të fëmijërisë

Pika e nisjes

Studimet moderne¹ tregojnë se afërsisht 46% e fëmijëve përjetojnë një formë traume, që shpesh rezulton në plagë të thella dhe të qëndrueshme emocionale. Këto përvoja traumatike mund të përfshijnë abuzimin fizik ose seksual, humbjen e një personi të dashur, fatkeqësitë natyrore, aksidentet ose rritjen në një mjedis të pasigurt ose të neglizhuar. Edhe stresi i përditshëm - si mungesa e dashurisë dhe mbështetjes në shtëpi - mund të ketë pasoja serioze.

Trauma ndikon në aftësinë e fëmijëve për të rregulluar emocionet, për t'u përqendruar, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të ruajtur shëndetin fizik. Studimet tregojnë se 15% e vajzave dhe 6% e djemve zhvillojnë çrregullime të stresit post-traumatik (PTSD), duke shfaqur simptoma të tilla si zemërimi, ankthi, përqendrimi i dobët, shqetësimet e gjumit dhe ndryshimet në oreks.

Trauma e fëmijërisë gjithashtu ndikon në zhvillimin e trurit dhe rrit rrezikun e sëmundjeve kronike si astma, sëmundjet e zemrës, diabeti dhe madje edhe kanceri. Këto efekte mund të vazhdojnë gjatë gjithë jetës, duke e bërë ndërhyrjen e hershme dhe mbështetjen e informuar për traumën thelbësore.

SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut, me mbi 20 vjet përvojë, raporton se traumat janë edhe më të shpeshta dhe më intensive tek fëmijët pa kujdesje prindërore. Thjesht zhvendosja e fëmijëve nga institucionet rezidenciale në kujdesin familjar ose në kujdesin e ngjashëm me atë familjar nuk mjafton për të shëruar efektet e traumave të hershme.

Gjetja e rrugës së duhur

Duke pranuar nevojën urgjente për t'i trajtuar këto çështje, SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut futi qasjen e Kujdesit të Informuar për Traumën (KIT) në sistemin e mbrojtjes sociale. KIT-i fokusohet në ndërgjegjësimin e profesionistëve dhe forcimin e sistemit të mbështetjes për fëmijët dhe familjet vulnerabël. Integrimi i tij në sistem u projektua në mënyrë të tillë që të ishte holistik—duke rritur kapacitetin e profesionistëve për të përdorur KIT-in në punën e tyre të përditshme, duke mbështetur ofruesit e shërbimeve në përfshirjen e KIT-it në planet e tyre të zhvillimit organizativ dhe duke propozuar ndryshime të përshtatshme legjislative.

Nisma u përafërua me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna 2020–2025.

¹ Un Sun Chung - Departamenti i Psikiatrisë, Spitali i Fëmijëve i Universitetit Kombëtar Kyungpook, Shkolla e Mjekësisë, Universiteti Kombëtar Kyungpook

Destinacioni: Përmirësimi i standardeve

SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut identifikoi të gjithë aktorët përkatës dhe formoi një grup pune për të siguruar pranimin institucional dhe për të hartuar përmirësime legjislative.

Përpyekjet për ngritjen e kapaciteteve u shtrinë në të gjithë sektorët dhe nivelet - nga politika kombëtare deri te ofrimi i shërbimeve vendore. U prezantua një model i "trajnimit të trajnerit" për të forcuar aftësinë e profesionistëve për të transferuar njohuritë, duke siguruar qëndrueshmëri. Gjithashtu u ofruan trajnime për familjet kujdestare për t'i ndihmuar ato të kuptojnë më mirë traumën dhe të mbështesin fëmijët në kujdesin e tyre.

Të rinjtë që u rritën në përkujdesje u përfshinë në mënyrë aktive në procesin e trajnimit, duke sjellë histori personale dhe duke marrë pjesë në diskutimet e rasteve studimore. Kontributet e tyre e bënë trajnimin më të rëndësishëm dhe më me ndikim, duke rritur gjithashtu kapacitetin e tyre për t'u përfshirë në çështje të lidhura me traumën.

Programi është akredituar zyrtarisht nga Instituti Kombëtar i Veprimtarive Sociale në Shkup.

U zhvilluan seminare në qendrat e kujdesit familjar, duke përfshirë SOS Fshatin e Fëmijëve Shkup dhe katër institucione shtetërore të kujdesit për fëmijët në Shkup dhe Manastir, për të mbështetur zhvillimin organizativ dhe zbatimin e qasjes së Kujdesit të Informuar për Traumën (KIT). Këto përpjekje çuan në përgatitjen e planeve operacionale dhe ndryshimet në rregulloret e brendshme, duke ngulitur më tej praktikat e informuara për traumat në sistemin e mbrojtjes sociale.

Përmirësimet legjislative janë hartuar në bashkëpunim me përfaqësues të institucioneve kombëtare. Rekomandimet mbështesin zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, e cila i garanton çdo fëmijë të drejtën për të jetuar pa dhunë, abuzim dhe neglizhencë në të gjitha mjediset - në shtëpi, shkollë dhe në institucionet e kujdesit. Ato janë gjithashtu në përputhje me qasjen strategjike të BE-së për shëndetin mendor, siç përshkruhet në COM(2023)298, i cili thekson aksesin në kujdesin parandalues, trajtimin me cilësi të lartë dhe riintegrimin në shoqëri.

Janë përgatitur rekomandimet për përmirësimin e dy akteve nënligjore për shërbimet sociale dhe i janë paraqitur për miratim ministrisë përgjegjëse.





Mësimet tona / Për bashkudhëtarët në rrugën e ndryshimit

Nisma për të ndërtuar një sistem efikas për trajtimin e traumave të fëmijërisë mbledhi së bashku profesionistë nga sektorë të ndryshëm dhe inkurajoi dialogun ndërdisiplinor. Ky bashkëpunim nxiti një të kuptuar më të thellë të traumës dhe krijoi angazhim për veprime efikase dhe të koordinuara. Ndonëse përfshirja e aktorëve të ndryshëm kërkon burime, energji dhe kohë të konsiderueshme, përvoja jonë tregoi se ajo nxiti mirëkuptimin e përbashkët, harmonizimin rreth qëllimeve të përbashkëta dhe një ndjenjë të fortë pronësie.

Duke promovuar bashkëpunimin ndërsektorial dhe investimin në trajnime, mjete praktike dhe ndryshim të mendësisë, SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut hodhi themelet për ndryshime afatgjata dhe të qëndrueshme.

”

Trajnimi për Kujdesin e Informuar për Traumën më ndihmoi të kuptoja thellë se si trauma ndikon në shëndetin psikologjik dhe fizik të njerëzve dhe se si kjo mund të ndikojë në sjelljen e tyre. Në punën time të përditshme, fillova të zbatoj strategji të cilat përfshijnë përshtatjen e qasjes sime ndaj klientëve. Për shembull, u bëra më i ndjeshëm ndaj reagimeve dhe nevojave të tyre, të cilat më ndihmuan të krijoj një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Fillova të kujtoja mënyrat e mia të komunikimit, si shmangia e qëndrimeve akuzuese dhe tepër autoritare, si dhe përdorimi i gjuhës që është më i qartë dhe mbështetës. Mësova të njoh sinjalet e stresit ose të mbingarkesës së klientëve dhe t'u ofroj atyre strategji për vetë-qetësim ose ndryshim të burimeve për mbështetje shtesë. Si rezultat, aftësia ime për të krijuar besim dhe siguri me klientët është përmirësuar, gjë që e bëri procesin e punës më efikas dhe më të përshtatshëm për nevojat e tyre individuale.

Aleksandar Mitanoski , përfaqësues i institucionit shtetëror për fëmijë me sjellje të vështira

”

Trajnimi i Trajnerëve për Kujdesin e Informuar për Traumën ishte një kombinim i shkëlqyer i lëndëve të rëndësishme, pikëpamjeve dhe qasjeve moderne dhe aktuale, dhe trajnerëve të shkëlqyer. ... Që atëherë, pothuajse të gjitha leximet e mia profesionale ishin, dhe sinqerisht edhe tani, dy vjet më vonë, janë ende të përqendruara në temën e traumës.

[Trajnim] bëri ndryshime fillestare, por domethënëse në qasjen dhe shërbimin ndaj klientëve përmes rritjes së nivelit të ndjeshmërisë ndaj traumës, njohjes së shenjave, mbështetjes së ndryshimit me gjuhë pozitive, përfshirë shëndetin mendor dhe kujdesin për mirëqenien mendore në dokumentet tona.

Me këtë, unë dhe trajnerët e tjerë u bëmë agjentë të ndryshimit dhe ndikimit në fushën e traumës.

Jasmina Koçankovska , përfaqësuese e Qendrës Shtetërore të Mbështetjes së Familjeve Kujdestare, Manastir

”

Ajo që i bën trajnimet shumë të dobishme është fakti se ato bazohen në njohuri që tashmë janë zbatuar me sukses në punë që ngjasojnë shumë me punën tonë. Domethënë, trajnimet nuk janë teorike, por shumë praktike. Diskutojmë situata specifike të jetës që kemi hasur me fëmijët, në të cilat na mungonte të kuptuarit e mjaftueshëm për vetë situatën, arsyet që çojnë në të, si dhe qasjen e duhur dhe gjetjen e zgjidhjeve të suksesshme.

Mite Goshev , prind birësues

”


Takova njerëz të rinj, por hasa në diçka edhe më të rëndësishme - kuptova se për një kohë të gjatë po ikja nga tema e traumës. E vërteta është, herët a vonë, se të gjithë duhet të përballen me demonët e tyre. Falë trajnimit, jo vetëm që ndalova së fshehuri nga e vërteta, por edhe erdha plotësisht në vete.

Marija Samardziska, individ që ka dalë nga kujdesi.

Ukraina

Vendi i dytë më i madh i Evropës, Ukraina, ka një popullsi prej rreth 43.8 milionë banorësh. Kur filloi lufta me Rusinë në shkurt 2022, rreth 14.3 milionë njerëz u zhvendosën nga Ukraina brenda vendit dhe në vendet anembanë Evropës. Ndonëse disa janë kthyer në vend, më shumë se 7 milionë njerëz mbeten të zhvendosur brenda vendit në Ukrainë. Shumica e atyre që janë zhvendosur janë gra dhe fëmijë, gati një e treta e të cilëve janë zhvendosur më shumë se një herë, dhe pothuajse 1 në 10 janë zhvendosur tre herë ose më shumë.

SOS Fshatrat e Fëmijëve ka mbështetur fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë, në Ukrainë që nga viti 2003.



Projekti në Ukrainë

Nisja e pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës nga Federata Ruse e ndryshoi kontekstin me shpejtësi. Si përgjigje, projekti u përshtat për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve sociale gjithnjë e më të nevojshme të bazuara në komunitet dhe familje për fëmijët dhe familjet në nevojë, dhe ndërtimin e konsensusit shoqëror mbi nevojën për të zbatuar reformat e deinstitutionalizimit.

Projekti u fokusua në dy rajone që mbulojnë komunitetet e mëposhtme:

- Rajoni i Kievit: Boyarka , Borodianka , Irpin, Fastiv ;
- Rajoni Ivano-Frankivsk: Horodenka , Kolomyia , Ivano-Frankivsk

Arritjet kryesore

Përmirësimi i legjislacionit dhe politikave publike

SOS Fshatrat e Fëmijëve Ukrainë, së bashku me organizata të tjera qytetare, morën pjesë në formësimin e Strategjisë për Sigurimin e të Drejtës së Çdo Fëmije në Ukrainë për t'u Rritur në Mjedis Familjar për 2024-2028, e cila siguron të drejtën e çdo fëmije për t'u rritur në një mjedis familjar.

Reforma e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet deinstitutionalizimit nuk është vetëm çështje e politikës sociale - ajo ka rëndësi thelbësore për forcimin e ekonomisë dhe kapitalit njerëzor të Ukrainës. Duke investuar në kujdesin e bazuar në familje dhe në sistemet mbështetëse të komunitetit, Ukraina hedh themelet për kohezionin social afatgjatë, zhvillimin gjithëpërfshirës dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Deinstitutionalizimi luan gjithashtu një rol jetik në integrimin evropian të vendit. Ai pasqyron angazhimin e Ukrainës për t'u përafëruar me vlerat dhe standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushat e të drejtave të njeriut, mbrojtjes së fëmijëve dhe përfshirjes sociale. Prandaj, zbatimi

i suksesshëm i kësaj reforme është një detyrim kombëtar dhe një hap thelbësor në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në BE.

Rritja e ndërgjegjësimit

Rreth 28 milionë njerëz u përshinë përmes fushatës kombëtare të titulluar “Të gjithë fëmijët janë tanët”. Fushata synonte të mbështeste miratimin e strategjisë së re të deinstitutionalizimit, të promovonte zhvillimin e kujdesit të bazuar në familje në komunitetet e synuara dhe të rriste ndërgjegjësimin për shërbimet sociale që ndihmojnë në parandalimin ose kapërcimin e rrethanave të vështira të jetës - duke u mundësuar përfundimisht fëmijëve të qëndrojnë në familjet e tyre biologjike.

- Një total prej 370 individësh morën pjesë në pesë veprimtari publike të titulluara “Dita e Zemrave të Hapura” në komunitetet e synuara, ku mësuan më shumë rreth shërbimeve sociale dhe kujdesit të ngjashëm me atë familjar, duke përfshirë edhe vetë kujdesin familjar.

- 381 vendimmarrës dhe aktorë morën pjesë në tryeza të rrumbullakëta për të shkëmbyer përvojat dhe modelet e ekselencës në vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, me synimin për të përvetësuar njohuri të reja.



- 9,369 pjesëmarrës morën pjesë në 47 webinare të organizuara për prindërit kujdestarë dhe profesionistët e shtetit.

Rritja e kapaciteteve

- Gjithsej 210 vendimmarrës dhe aktorë nga rajonet e synuara morën pjesë në trajnime dhe morën njohuri të reja - 91 për vlerësimin e nevojave dhe 119 për bashkëpunimin ndërin-

stitucional në interesin më të mirë të çdo fëmije.

- 70 vendimmarrës dhe aktorë janë trajnuar për planifikim dhe buxhetim në nivel vendor.
- 381 vendimmarrës dhe aktorë morën pjesë në tryeza të rrumbullakëta për të ndarë përvojat dhe modelet e ekselencës në vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe bashkëpunimin ndërinstytucional, me objektivin për të përvetësuar njohuri të reja.
- 502 profesionistë në rajonet dhe komunitetet e synuara (dhe më gjerë, përmes mundësive të trajnimit në internet) u trajnuan për teknika të efektshme: të tilla si qasja e menaxhimit të rasteve, ndërhyrja e hershme, këshillimi dhe trajnimi për kujdestarinë familjare dhe programet e prindërimit të bazuara në të dhëna.

Akses në shërbime cilësore

Pesë Qendra të Shërbimeve Sociale u rinovuan dhe u furnizuan me pajisje. Si rezultat:

- 807 fëmijëve pa kujdes prindëror iu ofruan shërbime të cilësisë së lartë të kujdesit alternativ në bashkitë e synuara.
- Për 2.651 fëmijë në rrezik dhe 2.366 prindër në katër komunitete u vunë në dispozicion shërbime inovative dhe me cilësi të lartë të mbështetjes dhe parandalimit të bazuar në komunitet.

Praktika jonë më e mirë

Ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i praktikave për mirëqenien e të gjithë fëmijëve tanë

Pika e nisjes

Para pushtimit në shkallë të gjerë, 96.577 fëmijë vulnerabël jetonin në kujdesin institucional në Ukrainë. Si kudo, kjo formë e kujdesit shkel të drejtat e fëmijëve. Shpesh nuk arrin të sigurojë një mjedis miqësor për fëmijët, kontribuon në shqetësime të konsiderueshme psikologjike dhe marginalizim social dhe pengon potencialin zhvillimor të fëmijëve të prekur.

Që nga fillimi i punës së tij në vitin 2003, SOS Fshatrat e Fëmijëve Ukrainë praktikisht e ka eliminuar vendosjen e fëmijëve në kujdesin institucional në Brovary, një komunitet lokal në Rajonin e Kievit. Kjo u arrit nëpërmjet promovimit të kujdesit familjar dhe ofrimit të shërbimeve parandaluese, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin vendor.

Duke u mbështetur në këtë përvojë - dhe të bindur për shkallëzueshmërinë e saj - u shtrimë tek komunitetet e tjera vendore, të cilat përballeshin të gjitha me sfida të ngjashme: shërbime nën standarde për fëmijët dhe familjet vulnerabël, rritje të popullsisë për shkak të luftës, financim të pamjaftueshëm, njohuri dhe aftësi të vjetruara në kujdesin ndaj fëmijëve dhe fusha të ngjashme, dhe mbështetje të vazhdueshme në kornizat e vjetruara dhe praktikave të njohura. Pavarësisht këtyre sfidave, ne ndamë një vizion të përbashkët: të përmirësojmë jetën e fëmijëve.

Gjetja e rrugës së duhur

Projekti fillimisht u shpall në tre rajone në Ukrainën qendrore dhe lindore: Zaporizhzhia, Luhansk dhe Kiev. Sidoqoftë, pushtimi në shkallë të gjerë në shkurt të vitit 2022 detyroi një zhvendosje të

fokusit nga Rajoni [i pushtuar] i Luhanskut dhe Rajoni [vija e parë] Zaporizhzhia në zona më të sigurta në përfundim të vendit.

Në vitin 2022, u zgjodhën gjashtë komunitete vendore, vetëm njëra prej të cilave—Brovary në Rajonin e Kievit—kishte tashmë një prani të krijuar të SOS Fshatrave të Fëmijëve. Vendndodhjet e mbetura përfshinin Fastivin dhe Borodyankan në Rajonin e Kievit dhe Uzhhorodinin, Ivano-Frankivskin dhe Lvivin. Në vitin 2023, projekti zëvendësoi Uzhhorodin dhe Lvivin me katër komunitete shtesë: Irpinin dhe Boyarkan në Rajonin e Kievit dhe Kolomyian dhe Horodenkan në Rajonin Ivano-Frankivsk.

Vlerësimet e nevojave u kryen duke përdorur një metodologji të re të prezantuar nga Ministria e Politikës Sociale dhe e vënë në dispozicion të shtatë komuniteteve të synuara, si dhe autoriteteve rajonale dhe partnerëve të OJQ-ve që punojnë në nivel komuniteti.

Vlerësimet zbuluan se shumë profesionistë ukrainas vazhdojnë të aplikojnë metodologji të vjetruara që nuk pasqyrojnë më njohuritë aktuale shkencore. Praktikantët e tyre mbeten kryesisht të formësuar nga ish-sistemi i bazuar në kujdesin rezidencial. Të gjitha komunitetet identifikuan nevojën që profesionistët e tyre të trajnohen në teknika moderne dhe të efektshme, duke përfshirë qasjen e menaxhimit të rasteve, riintegrimi i fëmijëve nga kujdesi alternativ në familjet e origjinës, forcimi i kapaciteteve prindërore dhe vlerësimi i nevojave.



Destinacioni: Përmirësimi i standardeve

Horodenka është një komunitet vendor në Rajonin Ivano-Frankivsk, që përfshin 40 vendbanime dhe një popullsi totale prej 45.700 banorësh, duke përfshirë rreth 5.500 fëmijë. Vlerat tradicionale të familjes dhe besimi luajnë një rol të rëndësishëm në këtë zonë kryesisht rurale, ku popullsia vendase tregon historikisht një vetëdijesim të fortë për çështjet e komunitetit. Ky kontekst ofroi një mundësi unike për të rritur angazhimin lokal dhe për të nxitur përfshirjen aktive.

Pas pushtimit në shkallë të gjerë, komuniteti u pushtua nga një fluks i njerëzve të zhvendosur brenda vendit të ndjekur nga sfidat shoqërore shëndetësore, sociale, ligjore, arsimore dhe të tjera. Nevoja më urgjente ishte mbështetja e triazhit, në të cilën SOS Fshatrat e Fëmijëve luajtën një rol kyç.

Në bashkëpunim me komunitetin vendor, u realizua një vlerësim i nevojave, duke çuar në vendime të bazuara në të dhëna dhe plane veprimi. Ndërkohë që masat emergjente u zbatuan menjëherë, u ndërmorën edhe veprime afatgjata zhvillimore - si investimet në objekte dhe rritja e kapaciteteve të stafit vendor. Komuniteti e kuptoi rëndësinë e të dyja qasjeve: veprimet emergjente trajtuan nevojat urgjente, ndërsa masat e zhvillimit siguruan qëndrueshmëri afatgjatë.


Si rezultat i drejtpërdrejtë i vlerësimit të nevojave, u krijua Qendra e Mbështetjes Sociale të Fëmijëve dhe Familjeve, e cila ofron këshillim psikologjik, mbështetje sociale për familjet në rrethana të vështira jetësore, mbështetje për familjet me jetimë dhe fëmijë të privuar nga kujdesi prindëror, ndërhyrje emergjente (krizë) dhe shërbime të tjera. Gjithashtu, u hap edhe një qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

SOS Fshatrat e Fëmijëve u angazhuan për një periudhë pesëvjeçare monitorimi dhe trajnimi të vazhdueshëm, ndërsa komunitetit vendor iu besua menaxhimi i funksionimit të përditshëm dhe plotësimi i personelit të objekteve.

U realizuan një seri trajnimesh online si dhe me prani fizike për të trajtuar nevojat e identifikuara për rritjen e kapaciteteve. Këto sesione përmirësonin njohuritë dhe aftësitë e profesionistëve vendas në fusha të tilla si ofrimi i shërbimeve sociale dhe parandaluese, metodologjia e riintegrit, menaxhimi i rasteve dhe programet e prindërimit të bazuar në të dhëna.

Me kërkesë të drejtpërdrejtë të komuniteteve vendore - të cilat treguan një të kuptuar të kufizuar të kuadrit ligjor dhe mënyrës së zbatimit të tij në praktikë - u zhvillua një trajnim për planifikimin dhe përgatitjen e buxheteve vendore. Ky trajnim mbuloi të gjitha fazat e procesit buxhetor, duke përfshirë mjetet për planifikimin e shërbimit social, legjislacionin që rregullon përgjegjësitë e qeverisjes vendore, metodat e llogaritjes së kostos së shërbimeve sociale dhe strukturën e buxhetit të komunitetit territorial.





Trajnimi mbi bashkëpunimin ndërsektorial ndihmoi në zbërthimin e qasjeve të izoluar të punës, duke ofruar lehtësim shumë të nevojshëm të stresit dhe strategji praktike për prioritizimin, delegimin dhe bashkëpunimin. Ai i ndihmoi profesionistët të ofrojnë paketa ndërhyrjeje të përshtatura për fëmijët dhe familjet vulnerabël.

Në Horodenka dhe gjashtë komunitetet e tjera të synuara - si dhe në komunitete të tjera të përfshira në mënyrë indirekte në projekt - numri i fëmijëve vulnerabël të vendosur në institucione rezidenciale nuk arriti objektivin e planifikuar të reduktimit prej 10%. Megjithatë, në nivel kombëtar numri u ul me 7.1%, nga 96.577 fëmijë (që nga 1 janari 2020) në 89.797 fëmijë (në tremujorin e tretë të vitit 2024).

Megjithatë, ky objektivi u vendos përpara pushtimit në shkallë të gjerë. Në kontekstin e një lufte të vazhdueshme, kjo arritje është një dëshmi e faktit se këmbëngulja dhe përkushtimi mund të nxisin përmirësime të mbrojtjes së fëmijëve dhe të shërbimeve sociale – pikërisht kur ato nevojiten më urgjentisht.

Mësimet tona / Për bashkudhëtarët në rrugën e ndryshimit

Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve vendore ishte një rezultat i pritur, megjithëse jozyrtar.

”

Këto trajnime kanë bashkuar shumë komunitete, pasi ka gjithmonë dikë për të shkëmbyer përvojë. Frymëzimi i mëtejshëm erdhi nga puna e SOS Fshatrave të Fëmijëve si ofrues i drejtpërdrejtë i shërbimit dhe partner në hartimin e një pakete të madhe sociale të aftë për t'iu përgjigjur të gjitha nevojave të fëmijëve dhe familjeve vulnerabël.

Andriy Tsyumpal , Nënkryetari i Këshillit në Horodenka

”

Njohuritë dhe aftësitë e fituara tashmë po japin rezultate.

Me këtë projekt, ne arritëm të bashkojmë profesionistë nga komunitete të ndryshme, t'i frymëzojmë ata të bëjnë ndryshime vendimtare për të garantuar interesat më të mira të fëmijëve. U realizua ky numër trajnimesh, u bënë studime, u realizuan vizita studimore dhe u hapën 5 qendra, ku njerëzit marrin mbështetjen e nevojshme. Jam i sigurt se ky rrjet do të ekzistojë edhe pasi të përfundojë projekti.

Antonina Zahrotska, Drejtuese e Projektit.

Lidhja e njohurive, frymëzimi i ndryshimit

Mësimet dhe shkëmbimet ndërmjet vendeve për reformat e kujdesit ndaj fëmijëve

Transformimi i sistemeve të mirëqenies së fëmijëve kërkon mësim, bashkëpunim dhe ide të reja të përbashkëta.

Profesionistë shtetërorë dhe jo-shtetërorë nga pesë vende u bashkuan nëpërmjet këtij projekti për të shkëmbyer përvoja, për të eksploruar qasje inovative dhe për të rritur ekspertizën dhe angazhimin e tyre për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe familjeve.

Mësimet dhe shkëmbimet në shifra

Mbi 300 profesionistë nga të gjitha vendet e projektit përfituan nga aktivitete të ndryshme të mësimit dhe shkëmbimet ndërmjet vendeve.

- 8 vizita studimore në pesë vende - Shqipëri, Armeni, Austri, Gjeorgji, Maqedoninë e Veriut dhe Uzbekistan - duke përfshirë 81 vendimmarrës shtetërorë dhe joshtetërorë dhe profesionistë nga katër vende - Shqipëria, Armenia, Bjellorusia dhe Ukraina.
- 14 webinarë online dhe takime shkëmbimi për 8 çështje respektive të zgjedhura.
- 3 takime shkëmbimi në Shqipëri, Gjermani dhe Maqedoninë e Veriut për stafin e projektit.
- 7 botime të buletinit të projektit "Ngushtimi i dallimit".
- 4 vizita mbështetëse teknike në Shqipëri dhe Armeni nga stafi rajonal i projektit.
- Krijimi i bibliotekës së burimeve virtuale të përditësuar rregullisht me studime, analiza, raporte kërkimore dhe dokumente legjislative dhe strategjike përkatëse ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.
- Zhvillimi i metodologjisë së përbashkët për planifikimin dhe zbatimin e fushatave ndërgjegjëse.

Aktivitetet e të mësuarit dhe shkëmbimit ofruan mundësi të vlefshme për vendimmarrësit, politikëbërësit dhe profesionistët e kujdesit për fëmijët për të eksploruar sisteme të ndryshme të kujdesit për fëmijët dhe përpjekjet për reforma. Ndarja e përvojave me kolegët mundësoi të mësuarit praktik për praktikën më të mira, sfidat e zakonshme dhe zgjidhjet e mundshme.

Temat e shkëmbimit u zgjodhën në mënyrë pjesëmarrëse. Përvojat në lidhje me reformat e mbrojtjes sociale, deinstitutionalizimin, transformimin e institucioneve rezidenciale në shërbime me bazë komunitare, llogaritjen e kostove të shërbimeve sociale, mekanizmat e licencimit dhe kontraktimit, si dhe forcimin e sistemeve të kujdesit familjar dhe parandalimit, krijuan interes të gjerë në të pesë vendet.

Pjesëmarrësit u angazhuan në mënyrë aktive në mësimin rreth kornizave ligjore dhe politikave të njëri-tjetrit, në programet inovative që promovojnë kujdesin e bazuar në familje, në mbështetjen për jetesë të pavarur për të rinjtë dhe në sistemet e trajnimit për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve. Ata eksploruan rolin e vetëqeverisjes vendore brenda sistemeve kombëtare të shërbimeve sociale, modelet e financimit, praktikën e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe procedurat e menaxhimit të rasteve të krijuara për të siguruar mbështetje tërësore të familjes.

Fokus i veçantë u vendos në shkëmbimet profesionale ndërmjet vendeve rreth metodologjive të reja të prezantuara, të tilla si zhvillimi i aftësive prindërore, strategjitë për identifikimin e familjeve kujdestare dhe Kujdesi i Informuar për Traumat.

Këto mundësi mësimi dhe shkëmbimi ishin më shumë se diskutime - ato ishin momente frymëzimi, lidhjeje dhe transformimi. Ata i ndihmuan profesionistët që të rimendojnë qasjet e tyre, të adoptojnë mjete, metoda dhe metodologji të reja dhe të sjellin shpresë të përtërirë për fëmijët dhe familjet në nevojë.

Duke ndarë mësimet e nxjerra, praktikatat e mira dhe sfidat, pjesëmarrësit u frymëzuan për të ndërmarrë veprime përtej kufijve. Tani jemi më të bindur se kurrë se duke mësuar nga njëri-tjetri, ne mund të ndërtojmë sisteme më të forta të shërbimeve sociale - dhe një të ardhme ku çdo fëmijë mund të përparojë.

”

Mësuam se si funksionon sistemi social në Shqipëri, si ofrohen dhe financohen shërbimet sociale dhe për shërbimet e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Shqipëri. Folëm për sfidat demografike dhe sistemin e bashkëpunimit midis bashkive dhe organizatave joqeveritare. Ishte e vlefshme të dëgjonim përgjigje të sinqerta për pyetjet rreth sfidave dhe vështirësive në punë.

përfaqësues bashkiak nga Ukraina në një vizitë studimore në Shqipëri

”

Shpresojmë që ministria jonë kombëtare të ketë parasysh të gjitha pikat e rëndësishme të procesit të deinstitutionalizimit këtu, si bazë për të arritur ndryshimin në vendin tonë!

përfaqësuesi i institucionit shtetëror nga Shqipëria në një vizitë studimore në Maqedoninë e Veriut

Publikuar nga:

SOS Fshatrat e Fëmijëve

Koordinatorët e përmbajtjes dhe redaktorë:

Elsa Osmani

Vladimir Lazovski

Kontribuesit:

Destemona Toptani (Shqipëri)

Anahit Avetisyan, Liana Mkrtchyan, Anahit Melkumyan (Armeni)

Hanna Vysotskaya (Bjellorusi)

Zharko Trajkov (Maqedonia e Veriut)

Antonina Zahrotska (Ukrainë)

Mbështetje editoriale:

Katerina Ilievska

Dizajni dhe faqosja:

Expertise D

Fotografi:

Të gjitha fotot: ©SOS Fshatrat e Fëmijëve



SOS
KINDERDÖRFER
WELTWEIT



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT



SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
SHQIPËRI